



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR KTHIMIN PËR PLOTËSIM TË DOKUMENTACIONIT TË KANDIDATËVE PËR KRYETAR
BASHKIA DURRËS DHE BASHKIA LEZHË TË DEPOZITUARA NGA PARTIA "ALEANCA KUQ
E ZI" PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR
2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 20.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për kthimin për plotësim të dokumentacionit të kandidatëve për Kryetar Bashkia Durrës dhe Bashkia Lezhë të depozituara nga Partia "Aleanca Kuq e Zi" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 67, dhe 6 neni 72 dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N:

Partia "Aleanca Kuq e Zi", me vendimin nr. 203 datë 23.04.2019 "Për regjistrimin si subjekt zgjedhor Partia Aleanca Kuq e Zi, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019" është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019".

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Partia Aleanca Kuq e Zi, ka paraqitur në KQZ dokumentacionin për regjistrimin si kandidat për kryetar bashkia Durrës z. Lorenc Ciko dhe kandidatit për kryetar bashkia Lezhë z. Pal Trashaj.



Nr. 596 i Vendimit

Data 19.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për kthimin për plotësim të dokumentacionit të kandidatëve për Kryetar Bashkia Durrës dhe Bashkia Lezhë të depozituara nga Partia "Aleanca Kuq e Zi" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Gjithashtu Partia Alenaca Kuq e Zi, Partia Bashkimi Liberal Demokrat, Partia Demokracia e Re Europiane, Partia Aleanca Popullore, Partia Balli Kombëtar, Partia Emigracionit Shqiptar, Partia Ora e Shqipërisë janë pjesëtare të Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", regjistruar nga KQZ me vendimin nr. 273, datë 10.05.2019. Partia Aleanca Popullore ka depozituar në KQZ me datë 13.05.2019 "Kërkesë për heqje dorë nga rregjistrimi si parti politike në zgjedhje".

Në mbledhjen e datës 19.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi dokumentacionin e kandidatit për Kryetar Bashkie Durrës, z. Lorenc Ciko, dhe kandidatit për Kryetar Bashkie Lezhë z. Pal Trashaj dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi mangësitë e dokumentacionit si më poshtë:

1. Kërkesë për regjistrimin e z. Lorenc Ciko kandidat për Kryetar të Bashkisë Durrës dhe z. Pal Trashaj, kandidatit për Kryetar të Bashkië Lezhë sipas parashikimeve në Kodin Zgjedhor për propozimin e kandidatëve nga koalicioni zgjedhor;
2. Deklarata e kandidatit i cili deklaroi se gëzon të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar;
3. Vërtetim nga Kuvendi i Shqipërisë/Këshilli i Bashkisë për zotërimin e mandateve ose listat mbështetëse të zgjedhësve;
4. Kopje e letërnjoftimit.

Të kthej për plotësim dokumentacionin e kandidimit, për korrigjimin e mangësive të konstatuar nga sa sa më sipër.

Të kthej për plotësim dokumentacionin e kandidimit, për korrigjimin e mangësive të konstatuar nga kandidatët për kryetar bashkie.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 1, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrimin e kandidatit z. Lorenc Ciko për Kryetar të Bashkisë Durrës dhe z. Pal Trashaj kandidat për Kryetar të Bashkisë Lezhë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 596 i Vendimit

Data 19.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për kthimin për plotësim të dokumentacionit të kandidatëve për Kryetar Bashkia Durrës dhe Bashkia Lezhë të depozituara nga Partia "Aleanca Kuq e Zi" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019